



## Që fëmiju Juaj të rritet shëndetshëm –

### prezantohet „Zentrale Stelle Gesunde Kindheit“ (qendra për fëmijëri të shëndosh)

Të gjithë prindërit i lidhë dëshira që fëmijët e tyre të rriten shëndosh dhe mirë. Për të nxitur një zhvillim të shëndetshëm, secili fëmijë në Vestfalin Veriore (Nordrhein-Westfalen) ka të drejtë për dhjetë kontrollime preventive. Nga U1 (menjëherë pas lindjes) deri tek U9 në vitin e gjashtë të jetës. Me këtë, pa ndonjë përjashtim.

Të gjithë fëmijët bë Vestfalin Veriore (Nordrhein-Westfalen) duhen që të arrihen nga ky shërbim, prandaj „Zentrale Stelle Gesunde Kindheit“ i mbledhë të dhënat mbi kontrollimet e hershme preventive. Kjo funksionon si në vijim: Për çdo fëmijë, i cili ka marrë pjesë në ndonjë nga gjashtë kontrollimet e hershme preventive (U5 deri U9) në moshën nga gjashtë muaj deri në pesë vite e gjysëm, mjekja ose mjeku e dërgon një vërtetim tek „Zentrale Stelle Gesunde Kindheit“. Ngase mund të ndodhë lehtë që në jetën e përditshme, një datë për kontrollim preventiv të harrohet, apo ndoshta disa prindër nuk janë në dijeni mbi kontrollin paraprakë, atëherë „Zentrale Stelle Gesunde Kindheit“ i skedon të gjithë fëmijët, për të cilët nuk është konfirmuar pjesëmarrja. Disa ditë pas skadimit të periudhës, në të cilën do të duhej të kryhej kontrollimi (në U5 14 ditë para skadimit të periudhës), prindërit do të pranojnë një letër, me një kujtesë.

Nëse zyra qendrore nuk merr asnjë vërtetim ekzaminimi deri në gjashtë javë pas shkresës së kujtesës, atëherë komuna kompetente e rezidencës do të informohet për këtë problem. Pas kësaj, komuna vendos në autoritetin e saj të plotë nëse do të kontaktohen prindërit dhe për mënyrën e kontaktit të tyre. Në këtë mënyrë, familjes mund t'i ofrohet mbështetje nëse nevojitet.

### **Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:**

Zentrale Stelle Gesunde Kindheit  
Telefon: 0234 91535-2222  
(Orari i punës: E hënë-E enjte ora 9:00-12:00)  
Internet: [www.gesunde-kindheit.nrw.de](http://www.gesunde-kindheit.nrw.de)

Albanisch, Stand: 02/2022

Landeszentrum Gesundheit  
Nordrhein-Westfalen

